

RAPORT MONITORIMI

Aksesi në Arsimin e Larte

Gusht-Tetor 2020



AUTOR
Migen Qiraxhi

QENDRESA
QYTETARE



National Endowment
for Democracy


www.qeverisja.qq.com.al



1. Faktorët që ndikojnë në aksesin në arsim

Ndryshimi i shpeshtë i filozofisë së sistemit arsimor, nga ai Finlandez tek sistemi Gjerman dhe më pas tek ai Anglo-Sakson, pa patur më parë një studim paraprak dhe pa kontekstualizuar këto ndryshime me realitetin e vendit tonë, ka krijuar një klimë jo favorizuese për procesin e pranimeve në IAL-të publike. Ndryshimet e shpeshta të kriterëve të pranimit gjatë rrugës së formimit të tyre nuk i ndihmojnë maturantët që të përputhin ritmet e studimeve të tyre me këto kriterë.

Nga ana tjetër, në aspektin strategjik, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk adreson në mënyrë të decentralizuar procesin e pranimeve në IAL-të publike, si për ciklin e parë të studimeve, ashtu edhe për të dytin, edhe pse Ligji 80/2015, në nënë të ndryshme të tij i ka njohur një sërë kompetencash universiteteve për mbarëvajtjen e procesit pranues të studentëve.¹



Shpesh edhe situata ekonomike kthehet në pengesë për qasjen e të rinjve në universitet. Sipas raportit të Friedrich Ebert “Pabarazia në Europën Juglindore”, vetëm 1% e personave që vijnë nga shtresat e varfra kanë akses në arsimin publik apo privat. Në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, kjo shifër varionte nga 4% në 11%.²

Diskriminimi i të rinjve të shtresës së varfër dhe të zonave më të varfra të vendit për shkollim universitar thellohet akoma më shumë në studimet e ciklit të dytë (Master), për shkak të kostos së papërbalueshme të studimeve. Madje, këtë e lejon edhe vetë ligji i arsimit të lartë (80/2015), i cili, jo vetëm që nuk parashikon tavan për tarifën e studimeve në universitetet publike, por i jep mundësi

¹ Shih për shembull Neni 3 - Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë, Neni 4 - E drejta për arsimim, Neni 23 – Fakulteti, Neni 69 - Format e studimeve dhe pranimi në institucionet e arsimit të lartë, Neni 76- Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve, të ligjit 80/2015.

² <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/sarajevo/14452.pdf>

universiteteve publike të vendosin tarifa më të larta se sa kostoja reale e studimeve.

Nisur nga situata e pandemisë në vend dhe rënia ekonomike që po kalon vendi ynë, edhe shifra 1% e evidentuar për vitin akademik 2018 – 2019, priret të shkojë drejt rënies. Nga ana tjetër universitetet dhe MASR për shkak të mungesës së akteve nënligjore nuk po fillojnë implementimin e sistemit të kredisë studentore, për studentët që nuk kanë mundësi financiare dhe dëshirojnë të vijojnë studimet Bachelor dhe Master, në mënyrë që ata të kenë mundësi të shkollohen dhe, pasi të punësohen, të fillojnë të kthejnë kredinë me lehtësira të kushtëzuara nga rezultatet e arritura në studimet e përfunduara.

Pra faktorët që ndikojnë drejtpërdrejt në aksesin e studentëve në arsim, janë ndryshimet e njëpasnjëshme të politikave, siç është edhe rasti i kriterit të mesatares pranuese, roli centralizues i MASR në raport me universitetet dhe pamundësia ekonomike e familjeve të studentëve për të paguar studimet.



2. Kriteri i notës mesatare

Më 3 qershor 2020 Këshilli i Ministrave rriti pragun e notës mesatare kriter për të aplikuar në universitet nga nota 6 në 6.5 për këtë vit akademik dhe 7

2. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2021-2022 dhe në vijim, përkatësisht, si më poshtë:

- a) Në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë minimalisht me notë mesatare 7 (shtatë);
- b) Në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor", të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë "Master" në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr.2, të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 8 (tetë).

për vitin akademik 2021 – 2022. Ndërsa për programet e studimit me mundësi askesi në mësuesi nota mesatare u vendos 8-ta. Nota mesatare dysheme e përcaktuar nëpërmjet këtij Vendimi të Këshillit të Ministrave përbën risk që target grupi i studentëve me mesatare më të ulët të synojë studimin jashtë Shqipërisë duke qenë se ky kriter nuk aplikohet në të gjitha vendet e Rajonit apo Europës. Gjithashtu, i aplikuar pa një strategji dhe në mënyrë të menjëhershme, kriteri i mesatares mund të kthehet në kriter abuzimi, pasi nxënësit që e kanë siguruar lehtësisht notën mesatare në shkolla ku ajo merret lehtë për arsye të ndryshme, të jenë fitues fiktivë të së drejtës për të hyrë në universitete."

Degët me akses në ciklin master në mësuesi kanë qenë më të prekura nga VKM-ja e kriterit të mesatares. Për vitin akademik 2016-2017,³ 2017-2018⁴ dhe 2018-2019⁵ mesatarja ishte 6, ndërsa për vitin akademik 2019-2020 kjo mesatare u rrit në 6.5 (gjashtë pikë pesë)⁶. Për vitin akademik 2020-2021 për programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë është minimalisht me notë mesatare 7.5 (shtatë pikë pesë) dhe për vitin akademik 2021 – 2022 e vijim është miratuar të shkojë në notën 8⁷ Pra në tri vite akademike rresht kjo politikë ka ndryshuar duke u rritur tre herë, duke krijuar konfuzion, paqartësi dhe presion tek maturantët, të cilët përtej përgatitjes për provimet e maturës dhe mundësive financiare kanë për të kaluar edhe barrierën e kriterit të mesatares.

Duhet theksuar se programet e studimit të ciklit bachelor në degët e mësuesisë janë programe që nuk diplomojnë mësues, pasi ky titull fitohet pas përfundimit të ciklit të dytë master. Kjo politikë shtetërorë nuk ka ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësuesve, madje politika, sipas së cilës një gamë e gjerë e degëve të studimit të ciklit të parë cilësohen si degë që japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë, me justifikimin që ky është një profesion i rregulluar, po penalizon universitetet.



3. Situata e IAL-të publike në rrethe pas raundit të dytë të pranimeve në Universitete

Për të parë se si janë implementuar këto politika qeveritare në praktikë dhe si kanë ndikuar në procesin e pranimeve në universitetet e rretheve janë analizuar pranimet gjatë raundit të dytë dhe të tretë të pranimeve për vitin akademik 2020 - 2021, i cili në aspektin numerik nuk sjell ndryshime të mëdha në raport me raundin e tretë. Këto të dhëna janë krahasuar edhe me dy vitet e mëparshme të pranimeve në të njëjtat universitete.

³ VKM nr. 407, datë 1.6.2016. Shih në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2016/06/01/407>

⁴ VKM Nr. 346, datë 19.4.2017. Shih në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/04/19/346>

⁵ VKM Nr. 216, datë 20.4.2018, i ndryshuar. Shih në: <file:///C:/Users/eralda/Downloads/vendim-2018-04-20-216.pdf>

⁶ VKM Nr. 295, datë 10.5.2019. Shih në: <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2018/05/21/18>

⁷ VKM nr. 436, datë 3.6.2020 „Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021-2022 e në vijim“. Shih në: <file:///C:/Users/eralda/Downloads/vendim-2020-06-03-436.pdf>

Ajo që vihet re është fakti se gjatë këtij viti akademik janë shtuar aplikimet në universitete e rretheve në krahasim me dy vitet e kaluara, por sërisht vijon fenomeni i mbylljes së programeve të studimit. Në rastet kur për dy vite rresht, një degë studimi nuk plotësohet me **numrin minimal prej 10 studentësh**, ajo degë mbyllet automatikisht. Megjithëse prurjet e reja universitete e rretheve këtë vit janë shtuar, edhe për mungesë të mobilitetit të studentëve për shkak të pandemisë, nuk kanë qënë të suksesshme për të mbajtur hapur degët e studimit.

Degët më të preferuara për studentët shqiptarë për këtë vit akademik kanë qënë ato të infermierisë dhe teknologjisë së informacionit. Vihet re që në mungesë të orientimit të tregut shqiptar të punës, tregu ndërkombëtar dhe kërkesa për infermierë sidmomos në Gjermani ka përkuar me dëshirën e të rinjve për t'u diplomuar në këto degë, me qëllim emigrimin në Europë. Gjatë këtij viti akademik sistemit arsimor do ti shtohen 1567 infermierë të përgjithshëm, 468 infermierë Mami dhe 311 fizioterapistë, shifra të cilët çdokush e kupton që nuk lidhen me kërkesat e tregut vendas të punës. Në total në këto degë do të ulen në bankat e universiteteve 2346 studentë.

Degët e "eksportit"	2020 - 2021	Publik	Privat
Infermieri e Përgjithshme	1567 ↑	1032	535
Infermieri Mami	468 ↑	468	0
Fizio terapi	311 ↓	165	146
TOTAL	2346 ↑		



Universiteti “Luigj Gurakuqi”

Nëse do të shohim më specifikisht situatën e procesit të pranimeve në universitetet e vendit, në universitetin “Luigj Gurakuqi” këtë vit akademik në raundine dytë janë regjistruar 207 studentë më shumë se gjatë vitit akademik 2019 – 2020. Katër degë mbyllen dhe dy degë të reja shtohen këtë vit akademik. Degët më të preferuara këtë vit janë Infermiera, Informatika dhe Financa. Ndër degët që shkojnë drejt mbylljes janë Histori & Gjeografi, kanë një traditë të gjatë në këtë qytet.

1	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	Gjuhë -Letërsi	11
2	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	Gazetari dhe Komunikim	22
3	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Matematikë	11
4	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Informatikë	39
5	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Biologji -Kimi	10
6	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Infermieri e Përgjithshme	100
7	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Infermieri (Mami)	50
8	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Infermieri (Fizioterapi)	40
9	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Psikologji	31
10	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Punë Sociale	58
11	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Mësuesi për Arsimin Fillor	15
12	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Mësuesi për Arsimin Parashko	12
13	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Pikturë dhe Grafikë	26
14	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Pedagogji Muzikore	10
15	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Edukim Fizik dhe Sporte	75
16	Fakulteti Ekonomik	Administrim - Biznes	82
17	Fakulteti Ekonomik	Financë - Kontabilitet	97
18	Fakulteti Ekonomik	Turizem	67
19	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	Gjuhë Angleze	51
20	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	Gjuhë Gjermane	15
21	Fakulteti i Drejtësisë	Drejtësi	152
22	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	Gjuhë Italiane	6
23	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	Gjuhë Frënge	3
24	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	Histori	2
25	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	Gjeografi	4
			989

UNIVERSITETI “LUIGJ GURAKUQI” SHKODER



4/25 DEGE
Drejt mbylljes



207 Studente
me shume se
2019 (raundi2)
+ 60 Student (R3)
+ 3 Degë shpëtojnë
nga R2

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, **është i vetmi universitet nga rrethet i cili në raundin e dytë jo vetëm nuk ka pësuar rritje të numrit por ka një rënie me 17 student**, më pak të regjistruar se në vitin akademik 2019- 2020. Kjo rënie rikuperohet në raundin e 3të ku Elbasani në këtë raund ka rritjen më të lartë nga universitetet e rretheve me 101 studentë të cilët e kanë zgjedhur vetëm në fund të një procesi të gjatë regjistrimit në këtë universitet. Ndërkohë 20 nga 42 degë në këtë universitet shkojnë drejt mbylljes megjithëse 4 prej tyre u hapën për herë të parë këtë vit akademik. Degët më të preferuara këtë vit janë, infermiera dhe teknologjia e informacionit.

	Fakulteti	Dega	nr. stud.
1	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Gjuhë Angleze	17
2	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Program Profesional 2-vjeçar "	12
3	FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRES	Teknologjitë e Informacionit	61
4	FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRES	Teknologji Laboratori(2-vjeçar)	66
5	FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRES	Program Profesional 2-vjeçar "	60
6	FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT	Mësuesi për Arsimin Parashko	10
7	FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT	Punonjës Social	35
8	FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT	Eduktor për fëmijët 0-3 vjeç	57
9	FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT	Edukim Fizik dhe Sporte	80
10	FAKULTETI EKONOMIK	Administrim - Biznes	40
11	FAKULTETI EKONOMIK	Financë - Kontabilitet	57
12	FAKULTETI EKONOMIK	Ekonomia dhe e Drejta	24
13	FAKULTETI EKONOMIK	Informatikë Ekonomike	23
14	FAKULTETI EKONOMIK	Ekonomi Turizmi	13
15	FAKULTETI EKONOMIK	Administrim Biznesi dhe Inxhi	12
16	FAKULTETI EKONOMIK	Drejtesi	69
17	FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEK	Infermieri e Përgjithshme	200
18	FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEK	Infermieri - Mami	130
19	FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEK	Fizioterapi	76
20	FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEK	Logopedi	12
21	FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEK	Imazheri	70
22	FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEK	Teknik Laboratori	72
23	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Gjuhë Italiane	0
24	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Gazetari	9
25	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Gazetari dhe Gjuhë Angleze	7
26	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Gjeografi dhe gjuhë Italiane	0
27	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Histori dhe gjuhë gjermane	0
28	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Gjuhë Shqipe dhe Rome	0
29	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Gjuhë Frënge	0
30	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Gjuhë Italiane	0
31	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Gjuhë Gjermane	3
32	FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRES	Biologji - Kimi	0
33	FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRES	Matematikë - Fizikë	1
34	FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT	Filozofi - Sociologji	0
35	FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT	Psikologji	7
36	FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT	Mësuesi për Arsimin Fillor	8
37	FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT	Edukim Qytetar	0
38	FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRES	Fizikë Komputerike	0
39	FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRES	Matematikë Informatike	0
40	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Gjuhë shqipe dhe Letërsi	5
41	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Histori - Gjeografi	6
42	FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE	Gjuhë shqipe dhe frënge	0
	TOTALI I STUDENTEVE		1196

UNIVERSITETI “ALEKSANDER XHUVANI”, ELBASAN



20/42 DEGE
Drejt mbylljes



I vetmi univ. me
ulje te nr te
studenteve me
-17 nga 2019 (raundi2)



+ 101 Student (R3)
+1 Dege Shpëton



Universiteti “Eqerem Çabej” Gjirokastër

Universiteti “Eqerem Çabej” Gjirokastër, është një prej universiteteve më të rrezikuar sa i përket vijueshmërisë së tij në zonen e jugut të vendit. Pavarësisht se 14 nga 24 degë janë drejt mbylljes, nga të cilat 5 u hapën për herë të parë këtë vit, numri i të regjistruarve në raundin e dytë është 132 studentë më shumë se në vitin akademik 2019 – 2020. Por rreth 40% e studentëve të regjistruar janë bërë pjesë e programeve 2-vjeçare tek të cilat nuk aplikohet kriteri i mesatares. Degët më të preferuara këtë vit akademik janë Infermiera dhe Financa.

Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqër	Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek	12
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqër	Program Profesional 2-vjeçar "	39
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Teknologji Informacioni	10
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Infermieri e pergjithshme	74
Fakulteti Ekonomik	Kontabilitet - Financë	32
Fakulteti Ekonomik	Administrim –Publik	14
Fakulteti Ekonomik	Ekonomi Turizem	12
Fakulteti Ekonomik	Program profesional 2- vjeçar	30
Fakulteti Ekonomik	Program profesional 2- vjeçar	23
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqër	Gjuhë -Letërsi Shqipe	2
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqër	Gjuhë Angleze	4
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqër	Gjuhe Italiane	0
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqër	Histori dhe Gjuhë Italiane	2
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqër	Mësuesi për Arsimin Fillor	4
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqër	Mësuesi për Arsimin Parashko	3
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqër	Histori Gjeografi	1
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Biologji -Kimi	2
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Matematikë-Informatikë	1
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Infermieri Mami	6
Fakulteti Ekonomik	Program profesional 2- vjeçar	7
Fakulteti Ekonomik	Program profesional 2- vjeçar	9
TOTALI I STUDENTËVE		287
	107 Studentë Programe 2 vjecare	

UNIVERSITETI “EQEREM CABEJ” GJIROKASTER



12/21 DEGE
Drejt mbylljes



107 STUDENT
2 Vjecare



122 Studente
me shume se
2019
+ 7 Student (R3)
+ 3 Degë shpëtojnë
nga R2



Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë këtë vit akademik priti 133 studentë më shumë në raundin e dytë se në vitin akademik 2019 – 2020. Ndërkohë në përfundim të raundit të 3të 10 nga 28 degë shkojnë drejt mbylljes, megjithëse 2 prej tyre u hapën për herë të parë këtë vit akademik. Degët më të preferuara për vitin akademik 2020 – 2021 janë Infermieria dhe Financa.

Fakulteti	Dega	Nr. Stud
Fakulteti i Shkencave Teknike	Inxhinieri Mekanike	46
Fakulteti i Shkencave Teknike	Inxhinieri Elektrike	49
Fakulteti i Shkencave Teknike	Navigacion	13
Fakulteti i Shkencave Teknike	Informatike	13
Fakulteti i Shkencave Teknike	Teknologji Informacioni	19
Fakulteti i Shkencave Teknike	Shkenca Kompjuterike	27
Fakulteti i Shendetit Publik	Infermieri e pergjithshme	190
Fakulteti i Shendetit Publik	Infermieri Mami	90
Fakulteti i Shkencave Humane	Drejtesi	95
Fakulteti i Shkencave Humane	Gjuhe angleze	25
Fakulteti i Shkencave Humane	Pedagogji e specializuar	17
Fakulteti i Ekonomise	Finance	65
Fakulteti i Ekonomise	Kontabilitet	34
Fakulteti i Ekonomise	Administrim biznesi	34
Fakulteti i Ekonomise	Marketing	10
Fakulteti i Ekonomise	Ekonomiks	25
Fakulteti i Ekonomise	Menaxhim Turizem	17
Fakulteti i Shkencave Teknike	Inxhinieri Navale	8
Fakulteti i Shkencave Humane	Histori-Gjeografi	4
Fakulteti i Shkencave Humane	Gjuhe italiane	1
Fakulteti i Shkencave Humane	Mesuesi per Arsimin Fillor	6
Fakulteti i Shkencave Humane	Mesuesi per arsimin Parashkollor	6
Fakulteti i Shkencave Humane	Gjuhe Shqipe dhe Letersi	3
Fakulteti i Shkencave Teknike	Kimi	0
Fakulteti i Shkencave Teknike	Fizike	0
Fakulteti i Shkencave Teknike	Matematike Fizike	3
Fakulteti i Shkencave Teknike	Matematike	3
		803

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI”, VLORE



10/28 DEGE
Drejt mbylljes



133 Studente
me shume se
2019

+ 43 Student (R3)
+ 1 Degë shpëton
nga R2



Universiteti “Fan Noli” Korçë

Për universitetin “Fan Noli” Korçë, ky ka qënë një vit i suksesshëm në aspektin e prurjeve të reja, pasi ka pasur **296 studentë** më shumë të regjistruar në raundin e dytë se në vitin akademik 2019 – 2020. Vetëm 6 nga 32 degë studimi shkojnë drejt mbylljes, dhe degët më të preferuara këtë vit janë Infermiera, Financa dhe Edukimi fizik.

	Fakulteti	Dega	nr. stud.
1	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Huma	Administrim dhe Politika Socia	49
2	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Huma	Matematikë Informatikë	13
3	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Huma	Teknologji Informati	29
4	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Huma	Infermier i Përgjithshëm	60
5	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Huma	Biologji-Kimi	15
6	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Huma	Mami	30
7	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Huma	Program profesional 2- vjeçar	19
8	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Huma	Program profesional 2- vjeçar	36
9	Fakulteti i Ekonomisë	Financë- Kontabilitet	69
10	Fakulteti i Ekonomisë	Menaxhim	36
11	Fakulteti i Ekonomisë	Administrim Biznesi ne Marke	15
12	Fakulteti i Ekonomisë	Administrim Biznesi ne Turizë	10
13	Fakulteti i Ekonomisë	Program profesional 2- vjeçar	24
14	Fakulteti i Ekonomisë	Program profesional 2- vjeçar	38
15	Fakulteti i Ekonomisë	Bachelor në "Informatikë Bizn	15
16	Fakulteti i Ekonomisë	Ekonomiks	11
17	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Histori - Gjeografi	17
18	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Arsimi fillor Klasa I- VI	14
19	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Gjuhë Angleze	30
20	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Edukim për foshnjërinë dhe fëmijë	23
21	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Edukim fizik dhe sporte	45
22	Fakulteti i Bujqësisë	Agroushqim	10
23	Fakulteti i Bujqësisë	Inxhinieri Agronomike	12
24	Fakulteti i Bujqësisë	Menaxhim biznesi Bujqesor	24
25	Fakulteti i Bujqësisë	Menaxhim Veterinar	26
26	Fakulteti i Bujqësisë	Program profesional 2- vjeçar	17
27	Fakulteti i Ekonomisë	Bachelor në "Biznes dhe Tregti	3
28	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Gjuhë-Letërsi	7
29	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Arsim parashkollor	2
30	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Gjuhë dhe Kulturë Frënge	1
31	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Huma	Filozofi-Sociologji	6
32	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Huma	Matematikë- Fizikë	8
			714

UNIVERSITETI “F.S.NOLI”, KORÇE



6/32 DEGE
Drejt mbylljes



346 Studente
me shume se
2019 (raundi2)
+ 30 Student (R3)
+ 2 Degë shpëtojnë
nga R2



Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, është universiteti më i suksesshëm në përthithjen e studentëve në raport me vitin e kaluar akademik duke regjistruar **401 studentë më shumë në raundin e dytë** se në vitin akademik 2019 – 2020, ndërsa në raundin e tretë dhe përfundimtar ka shtuar 261 studentë të tjerë, me një numer total prej **2006 studentesh**. Ky universitet ka shtuar mundësitë për programet 2-vjeçare gjatë 3 viteve të fundit dhe si rezultat në këtë vit janë regjistruar 380 studentë në programet 2-vjeçare që ofron UAMD. Pavarësisht kësaj në aspektin strategjik kemi një problematikë, pasi 4 degët që shkojnë drejt mbylljes në këtë universitet lidhen drejtpërdrejt me mundësitë e punës në qytetin e Durrësit. Degët që shkojnë drejt mbylljes janë Menaxhim Turizëm Arkeologjik, Turizëm Kulturor,

Nr.	Fakulteti	Programi i studimit	Nr. Stud.
1	Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike	Drejtësi	255
2	Fakulteti i Biznesit	Financë Kontabilitet	160
3	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Infermeri e Përgjithshme	130
4	Fakulteti i Biznesit	Bankë Financë	96
5	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	Shkenca Kompiuterike	92
6	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	Teknologji Informacioni	78
7	Fakulteti i Biznesit	Administrim Biznesi	72
8	Fakulteti i Edukimit	Gjuhë Angleze	55
9	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Teknologji Automoblash	54
10	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Mami	51
11	Fakulteti i Biznesit	Menaxhim Marketing	49
12	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Fizioterapi	49
13	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	Aplikacion Web dhe Dizajn Grafik	48
14	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Ndihmës Dentist	41
15	Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike	Administrim Publik	41
16	Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike	Marrëdhënie me Publikun	41
17	Fakulteti i Biznesit	Shkenca Ekonomike	40
18	Fakulteti i Edukimit	Mësuesi për Arsimin Fillor Kl. I-VI	40
19	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	Specialist pajisjesh elektronike	39
20	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Menaxhim Transporti Detar/Tokësor	37
21	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Teknik Elektrik	36
22	Fakulteti i Edukimit	Gjuhë Gjermane dhe Angleze	35
23	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Navigation dhe Menaxhim Detar	32
24	Fakulteti i Edukimit	Psikologji	32
25	Fakulteti i Edukimit	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	28
26	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Menaxhim Ndërtimi	28
27	Fakulteti i Biznesit	Menaxhim Hotel Restorant	27
28	Fakulteti i Edukimit	Gjuhë Letërsi - Anglisht	27
29	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime	27
30	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Asistent Administrativ	26
31	Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike	Shkenca Politike	26
32	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Asistent Ujgor	23
33	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Specialist i Sistemeve të kondicionimit	21
34	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	Multimedia dhe Televizioni Dixhital	20
35	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Informatikë Praktike	20
36	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Specialist Rrjetesh Kompiuterike	19
37	Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike	Politikat Ekonomike	17
38	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	Sisteme Informacioni	14
39	Fakulteti i Biznesit	Komunikim me Marketing Digital	14
40	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	Matematikë Informatikë	12
41	Fakulteti i Studimeve Profesionale	Mekanik Impiante Industriale dhe Bujqësore	12
42	Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktiken	Mekanik Detare	10
43	Fakulteti i Biznesit	Menaxhim Turizëm Kulturor	9
44	Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktiken	Menaxhim i Bankave	7
45	Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike	Histori	6
46	Fakulteti i Edukimit	Filozofi - Sociologji	4
47	Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktiken	Menaxhim i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	3
48	Fakulteti i Biznesit	Menaxhim Turizëm Arkeologjik	2
49	Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktiken	Menaxhim Hoteleri Turizëm	1
		Total	2006

UNIVERSITETI “ALEKSANDER MOISIU”, DURRES



7/49 DEGE
Drejt mbylljes



401 Studente
me shume se
2019 (raundi2)
+ 261 Student (R3)



Mbyllen dege
me lidhje me
kontekstin lokal

Histori dhe Menaxhim Hoteleri Turizëm.

Gjetjet kryesore

- Kriza ekonomike e shkaktuar nga pandemia Covid19 rrezikon të vështirësojë aksesin e të varfërve në arsimin e lartë. MASR 5 vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit 80/2015 nuk filloi implementimin e sistemit të kredisë studentore, për studentët pa mundësi financiare.
- Mesatarja, kriter pranimi në universitet ka ndryshuar tre herë brenda tre vitesh pa studim apo strategji. Përveç efekteve negative në degët me akses mësuesinë, kriteri i mesatares mund të kthehet në kriter abuzimi në arsimin parauniversitar, duke prodhuar fitues fiktivë të së drejtës për të hyrë në universitete.
- Degët më të preferuara për studentët shqiptarë për këtë vit akademik kanë qenë ato të Infermierisë dhe Teknologjisë së Informacionit. Këtë vit sistemit arsimor do t'i shtohen 1319 Infermierë, 468 Mami dhe 262 Fizioterapistë, degë të cilat përkojnë me tregun ndërkombëtar dhe vijimin e eksodit të të rinjve jashtë Shqipërisë.
- Degët që shkojnë drejt mbylljes në të gjitha universitetet e rretheve janë Historia, Gjeografia dhe Gjuha shqipe. Shkak për këtë është bërë vendosja e mesatares, pavarësisht se këto degë janë shumë të rëndësishme për të formësuar një shoqëri me identitetet dhe integritet kombëtar.
- Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid19 dhe kufizimit të mundësive për të studiuar jashtë vendit, numri i studentëve që kanë zgjedhur të studiojnë në universitetet publike në rrethe është rritur në krahësim më vitin 2019 – 2020. I vetmi universitet publik në rrethe që ka vijuar tkurrjen është Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, me 17 studentë më pak se një vit më parë në raundin e dytë.
- Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, ka pritur numrin më të madh krahësuar më 2019 me një rritje prej 401 studentësh, por 4 degët që shkojnë drejt mbylljes në këtë universitet janë Menaxhim Turizëm Arkeologjik, Turizëm

Kulturor, Histori dhe Hoteleri Turizëm, degë të cilat strategjikisht lidhen drejtpërdrejt me tregun e punës së qytetit të Durrësit.

- Pavarësisht se 14 nga 24 degë janë drejt mbylljes në Universitetin “Eqerem Çabej” Gjirokastër, numri i të regjistruarve është 132 studentë më shumë se në vitin e kaluar, por rreth 40% e studentëve të regjistruar janë bërë pjesë e programeve 2-vjeçare tek të cilat nuk aplikohet kriteri i mesatares.

Rekomandime

- Këshilli i Ministrave duhet të miratojë vendimin për skemën e kreditimit studentor, si dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti dhe universiteti për aplikimin e kredisë, për t'i ardhur në ndihmë studentëve me mundësi të pakta ekonomike.
- Kriteret e pranimit në IAL-të publike, kuota dhe mesatarja në kuadër të autonomisë akademike, duhet të vendosen dhe të aplikohen nga vetë universitetet. Universitetet gëzojnë me ligj të drejtën e përcaktimit të kriterëve specifike të pranimit, të miratuara me VKM.
- Kriteri i notës mesatare duhet të vijë si pasojë e një studimi të të dhënave të mëparshme mbi pranimet në universitete dhe është më e nevojshme të aplikohet për kalimin nga cikli i studimeve bachelor në ciklin master duke siguruar një hyrje të lirë dhe dalje sipas meritës nga universiteti.
- Ministria e Arsimit dhe Universitetet duhet të hartojnë një strategji kombëtare mbi nevojat e tregut vendas të punës, në mënyrë që programet e studimit të ndërlidhen me nevojat vendase dhe jo me kërkesat e tregut ndërkombëtar të punës.

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE